



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2021:094220

Datë: 20.02.2025

Numri i dokumentit: 06877458

C.nr.2226/21

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË- Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtarja Shpresa Veselaj, në çështjen kontestimore të paditësve: G. B., P. V., M. N., R. N, dhe D. M., të cilët me autorizim i përfaqëson B. P., avokat nga Vushtrria, kundër të paditurës Ministria e Punëve të Brendshme- Policia e Kosovës - Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Kosovës, me seli në Prishtinë, për kompensim të pagës së 13- të, shujtave ditore dhe pagës jubilarë, jashtë seancës gjyqësore, me datën 20.02.2025 mori këtë:

A K T G J Y K I M

P a s h q y r t i m k r y e s o r t ë ç ë s h t j e s

I. APROVOHET pjesërisht si e bazuar kërkesëpadia e paditësve: G. B., P. V., M. N, R. N. dhe D. M.,

II. DETYROHET e paditura Qeveria e Republikës së Kosovës- Ministria e Punëve të Brendshme, Polica e Kosovës, Drejtoria e Përgjithshme në Prishtinë, që paditësve t'ua paguaj shumat si në vijim:

-G. B., në emër të shpërblimit të pagës së 13- të për fund vitet: 2018, 2019, 2020 dhe 2021, (për secilin prej këtyre viteve nga 575.01 €) t'ia paguaj shumën prej 2,300.04 €.

-P. V., në emër të shpërblimit të pagës së 13- të për fund vitet: 2018, 2019, 2020 dhe 2021, (për secilin prej këtyre viteve nga 696,00 €) t'ia paguaj shumën prej 2,784.00 €.

-M. N., në emër të shpërblimit të pagës së 13-të për fund vitet: 2018, 2019, 2020 dhe 2021, (për secilin prej këtyre viteve nga 570.24 €) t'ia paguaj shumën prej 2,280.96 €.

-R. N., në emër të shpërblimit të pagës së 13- të për fund vitet: 2018, 2019, 2020 dhe 2021, (për secilin prej këtyre viteve nga 531.90 €) t'ia paguaj shumën prej 2,127.60 €.

-D. M., në emër të shpërblimit të pagës së 13- të për fund vitet: 2018, 2019, 2020 dhe 2021, (për secilin prej këtyre viteve nga 649.60 €) t'ia paguaj shumën prej 2,598.40€.

E të gjitha këto me kamatë prej 8 % në vit, e cila fillon të llogaritet nga marrja e këtij aktgjykimi deri në pagesën definitive, në afat prej 7 ditësh nën kërcënimin e përmbartimit të detyrueshëm.

III. DETYROHET e paditura t'i paguaj shpenzimet e procedurës kontestimore, në shumë prej 724.00 €, në afat prej 7 ditësh nga marrja e këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbartimit të detyrueshëm.

IV. REFUZOHET në tërësi si e pabazuar pjesa tjetër e kërkespadi së paditësve sa ka të bëjë me kërkesat për kompensim të shpërblimit jubilar prej 25% të pagës bazë për secilin paditës veç e veç në shumë 142.00 €; dhe kërkesa e paditësve për kompensimin e të shujtave ditore nga 3 € në ditë për secilin paditës veç e veç në shumë prej 2,220.00 €.

A r s y e t i m

Paditësit përmes përfaqësuesit së tyre me datë 19.05.2021 kanë paraqitur padi, kundër të paditurës Qeveria e Republikës së Kosovës - Ministria e Punëve të Brendshme, Polica e Kosovës, Drejtoria e Përgjithshme në Prishtinë, për kompensim të pagës së trembëdhjetë, shujtës ditore dhe pagës jubilarë, pranë të cilës kanë mbetur edhe me parashtrësën e datës 22.04.2024. Duke qenë se paditësit janë në marrëdhënie pune tek e paditura dhe të njëjtit kanë vlerësim të kënaqshëm dhe nuk kanë qenë subjekt të asnjë mase disiplinore, ndërsa e paditura ka dështuar që paditësve t'ua paguaj secilit veç e veç shpërblimin e pagës së 13-të, shujtave ditore dhe shpërblimin jubilar, ndaj paditësit kanë kërkuar nga gjykata që ta aprovojë në tërësi kërkesëpadinë, dhe të detyrohet e paditura t'ua kompensojë paditësve shpërblimin e pagës së fund vitit, shpërblimin jubilarë dhe shujtat ditore dhe atë: paditësit G. B. pagat e 13-ta për vitet: 2018, 2019, 2020 dhe 2021 për secilin prej këtyre viteve t'ia paguaj nga 575.01 € = 2,300.04 €, pagën jubilarë për 16 vite përvojë pune, 25% të pagës = 142.00 €, si dhe shujtat për 740 ditë pune nga 3 € në ditë në shumë prej 2,220.00 €; paditësit P. V., në emër të shpërblimit të pagës së 13-të për fund vitet: 2018, 2019, 2020 dhe 2021, për secilin prej këtyre viteve t'ia paguaj nga 696,00 € = 2,784.00 €, pagën jubilarë për 16 vite përvojë pune, 25% të pagës = 142.00 €, si dhe shujtat për 740 ditë pune nga 3 € në ditë në shumë prej 2,220.00 €, paditësit M. N., në emër të shpërblimit për pagën e 13 për vitet: 2018, 2019, 2020 dhe 2021 t'ia paguaj nga 570.24 €, në shumë prej 2,280.96 €, pagën jubilarë për 16 vite përvojë pune 25% të pagës = 142.00 €, si dhe shujtat për 740 ditë pune nga 3 € në ditë 2,220.00 €; paditësit R. N., në emër të shpërblimit të pagës së 13-të për fund vitet: 2018, 2019, 2020 dhe 2021, për secilin prej këtyre viteve nga 531.90 €, shumën e përgjithshme prej 2,127.60, pagën jubilarë për 16 vite përvojë pune, 25% të pagës = 142.00 €, si dhe shujtat për 740 ditë pune nga 3 € në ditë 2,220.00 €; paditësit D. M., në emër të shpërblimit për pagën e 13-të për fund vitet: 2018, 2019, 2020 dhe 2021, për secilin prej këtyre viteve nga 649.60 € = 2,598.40 € dhe në emër të shpërblimit jubilar për 16 vite përvojë pune në vlerë të 25 % të një page mesatare të vitit 2021 në shumën prej 142.00 €, si dhe shujtat për 740 ditë pune nga 3 € në ditë 2,220.00 €. Me propozim për gjykatën që të aprovohet në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditësve.

Shpenzimet e procedurës i kanë kërkuar.

E paditura me përgjigje në padi të datës 14.12.2022, e ka kundërshtua në tërësi kërkesëpadinë e paditësve, si të pa bazuar. Në përgjigje e paditura ka theksuar se nuk është kontestues fakti se paditësit janë në marrëdhënie pune tek e paditura duke u mbështetur në vërtetimin e punësimit të lëshuar nga e paditura. Tutje ka theksuar se e kundërshton kërkesëpadinë e paditësit për sa i përket kompensimit të pagës së trembëdhjetë, pasi që nuk është realizuar për asnjë punonjës të Policisë së Kosovës, për shkak të mungesës së mjeteve financiare. Ka shtuar se Ministria e Financave në përputhje me nenin 19 të Ligjit nr.07/L-041 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2021, përkatësisht Ligjin nr. 05/L-125, neni 20 paragrafi 4 për

Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2017 nuk e ka aprovuar kërkesën e Policisë së Kosovës dhe si rrjedhojë e kësaj çdo veprim apo nismë, duke përfshirë edhe nenin 29 pika 2 të UA nr.02/2018 për Marrëdhënien e Punës në Policinë e Kosovës, i cili prodhon obligime financiare nuk është i obligueshëm përderisa nuk ka identifikuar paraprakisht burimin financiar, ashtu që në mungesë të mjeteve buxhetore – financiare nuk ka mundur të realizohet pagesa e pagës së 13-të. Më tej ka shtuar se kërkesa e paditësve për pagën e 13-të vlen vetëm brenda mundësive buxhetore të punëdhënësit dhe me asnjë dispozitë ligjore nuk është përcaktuar si detyrim i tani të paditurës. Me propozim për gjykatën që kërkesëpadia e paditësve të refuzohet në tërësi si e papabazuar.

Shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar.

Gjykata pas pranimit të përgjigjes në padi ka gjetur se janë plotësuar kushtet ligjore të përcaktuara me nenin 398 dhe 399 të LPK-së, për marrjen e aktgjykimit jashtë seancës, sepse në mes të palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, mirëpo nga e paditura mbetet kontestuese baza juridike e kërkesëpadisë dhe si rezultat i mungesë së linjës buxhetore për kërkesat e tilla. Gjykata vlerëson se nuk ekzistojnë pengesa për dhënien e vendimit meritör.

Pas shqyrtimit dhe vlerësimit të shkresave të lëndës gjykata gjeti se kërkesëpadia e paditësve është pjesërisht e bazuar.

Me nenin 398 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK-së) përcaktohet se: *“Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritör, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë.”*, lidhur me nenin 4 paragrafi 2 i LPK-së, në të cilin përcaktohet se: *“Ndryshe nga dispozita e paragrafit 1 të këtij neni, gjykata vendosë për kërkesëpadinë në bazë të veprimeve procedurale të shkruara dhe provave të administruara në mënyrë jo të drejtpërdrejt, po që se kjo përcaktohet me ligj”*.

Ndërsa për pjesën e refuzuar të kërkesëpadisë, gjykata vendosi konform nenit 399 të LPK-së, sipas të cilit përcaktohet se: *“Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadisë, atëherë ajo do të jep vendimin meritör me të cilin refuzohet si e pathemeltë kërkesëpadia”*.

Në mes të palëve ndërgjyqëse rezulton se nuk është kontestuese se paditësit janë në marrëdhënie pune tek e paditura, megjithatë gjykata këtë e vërtetoi edhe nga Vërtetimet e punësimit dhe atë: për paditësin e parë me nr. të referencës 04/1-02SRR/407/2021 i datës 29.03.2021; për paditësin e dytë me nr. të referencës 04/1-07-SRR-187/2021 i datës 04.04.2021; për paditësin e tretë me nr. të referencës 04/1-07-SRR-197/2021 i datës 07.04.2021; për paditësin e katërt me nr. të referencës 04/1-07-SRR-213/2021 të datës 07.04.2021 dhe për paditësin e pestë me nr. të referencës 04/1-07SRR169/2021 i datës 02.04.2021.

Nga vërtetimet e punësimit të theksuara, gjykata konstatoi se paditësi i parë G. B., ka filluar punën tek e paditura nga data 02.09.2002 dhe realizon pagë mujore në shumë prej 575.01 €; paditësi i dytë P. V, ka filluar punën tek e paditura nga data 20.01.2003 dhe realizon pagë mujore në shumë prej 696.00 €; paditësi i tretë M. N, ka filluar punën më datë 05.02.2014 dhe realizon pagë mujore 570.24 €; paditësi e katërt R. N, ka filluar punën më datë 01.08.2005 dhe realizon pagë mujore prej 531.90 €; ndërsa paditësi i pestë D. M, ka filluar punën më datë 23.09.2002 dhe realizon pagë mujore prej 649.60 €.

Nga formularët e vlerësimit të performancës, gjykata vërteton që paditësit kanë marrë vlerësime të kënaqshme të performancës në punë. Për të njëjtit, sipas formularëve e lartcekur të vlerësimit të performancës, gjykata gjeti se nuk ka shqiptim të ndonjë mase disiplinore.

Gjykata vlerëson se në rastin konkret zbatohen dispozitat e Udhëzimit Administrativ nr. 02/2018, mbi Marrëdhënien e Punës në Policinë e Kosovës, për kërkesat e paditësve që kanë të bëjnë me kompensimin e pagës së 13-të për vitet: 2018, 2019 dhe 2020; ndërsa për kompensimin e pagës së 13-të për vitin 2021 zbatohen dispozitat e Udhëzimit Administrativ nr. 01/2021 mbi Marrëdhënien e Punës në Policinë e Kosovës.

Me nenin 29 paragrafi 2 të UA nr.02/2018 përcaktohet se: *“Personelit të Policisë të cilët kanë marrë vlerësim të kënaqshëm dhe të cilët nuk kanë qenë subjekt i shqiptimit të ndonjë mase disiplinore brenda vitit përkatës, do të përfitojnë si shpërblim një pagë mujore ekuivalente me pagën e rregullt mujore në fund të vitit”.*

Me nenin 30 paragrafi 2 të UA nr.01/2021 përcaktohet se: *“Personelit të Policisë të cilët kanë marrë vlerësim të kënaqshëm dhe të cilët nuk kanë qenë subjekt i shqiptimit të ndonjë mase disiplinore brenda vitit përkatës, do të përfitojnë si shpërblim një pagë mujore ekuivalente me pagën e rregullt mujore në fund të vitit, nëse ka mjete buxhetore”.*

Nga interpretimi i dispozitave të Udhëzimeve Administrative: UA nr. 02/2018 dhe UA nr. 01/2021, si dhe pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, gjykata gjeti se kërkesëpadia e paditësve është pjesërisht e bazuar. Kjo sepse paditësit e gëzojnë të drejtën e pagës së 13-të që në fund të çdo viti kalendarik ta përfitojnë një pagë mujore, e cila do të jetë ekuivalente me pagën mujore në fund të vitit kalendarik përkatës, me kusht që atë vit kalendarik punonjësit e të paditurës, këtu paditësit të kenë vlerësim të kënaqshëm të performancës së punës, nëse nuk ju është shqiptuar ndonjë masë disiplinore brenda vitit përkatës. Gjykata gjeti se sipas formularëve të vlerësimit të performancës, që gjenden në shkresat e lëndës, konstatohet se paditësit, kanë vlerësim të kënaqshëm të performancës dhe të njëjtëve nuk ju është shqiptuar ndonjë masë disiplinore, gjatë viteve: 2018, 2019, 2020 dhe 2021. Për më tepër, e paditura nuk ka parashtruar ndonjë vërejtje, me anë të përgjigjes në padi, e që do të vinte në dyshim performancën e paditësve për vitet e lartcekura, e po ashtu nga e paditura nuk është ngritur as çështja e ndonjë mase disiplinore eventuale të shqiptuar ndaj ndonjërit prej paditësve.

Gjykata me rastin e vendosjes lidhur me lartësinë e kompensimit të pagës së 13-të për fund vitet: 2018, 2019, 2020 dhe 2021, mori për bazë vërtetimet e punësimit për secilin paditës veç e veç. Bazuar në nenin 319 par.3 të LPK-së, gjykata konstatoi se paditësi i parë G. B, realizon pagë mujore në shumë prej 575.01 €, ndaj të njëjtit në emër të shpërblimit të pagës së 13-të për vitet: 2018, 2019, 2020 dhe 2021, i takon shuma prej 2,300.04 €; paditësi i dytë P. V, realizon pagë mujore në shumë prej 696,00 €, ndaj të njëjtit për vitet: 2018, 2019, 2020 dhe 2021, i takon shuma prej 2,784.00 €; paditësi i tretë M. N, realizon pagë mujore në shumë prej 570.24 €, ndaj dhe të njëjtit i takon shuma prej 2,280.96 €; paditësi i katërt R. N, realizon pagë mujore në shumë prej 531.90 € ndaj dhe të njëjtit i takon shuma prej 2,127.60 €; paditësi i pestë D. M, realizon pagë mujore në shumë prej 531.90 € ndaj dhe të njëjtës të njëjtit takon shuma prej 2,598.40 €, siç është vendosur në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Duke qenë se e paditura nuk e ka përmbush detyrimin e saja ndaj paditësve, ndaj gjykata e detyroi të paditurën paditësve që t’ua kompensoj pagat e 13-ta për vitet: 2018, 2019, 2020 dhe 2021. Ndaj paditësit kanë cilësinë e kreditorëve ndërsa e paditura cilësinë e debitorit, bazuar në

nenin 245 të LMD- së, në të cilin përcaktohet se: *“Kreditori në marrëdhënien e detyrimit ka të drejtë që prej debitorit të kërkoj përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbush atë me ndërgjegje dhe në tërësi, në përputhje me përmbajtjen e tij.*

Në bazë të gjendjes së vërtetuar faktike, vendosi që ta detyroj të paditurën që paditësve t’ ua kompensoj shumat e gjykuara, si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata e refuzoi si të pabazuar pjesën tjetër të kërkesëpadisë së paditësve, për kompensimin e shpërblimit jubilar prej 25% të pagës bazë për 10 vite përvojë pune, për arsye se nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi G. B, 10 vite përvojë pune i ka arritur në vitin 2012, P. V, 10 vite përvojë pune i ka arritur në vitin 2013, M. N, 10 vite përvojë pune i ka arritur në vitin 2014, R. N, 10 vite përvojë pune i ka arritur në vitin 2015 dhe D. M, 10 vite përvojë pune i ka arritur në vitin 2012. Ndaj gjykata e refuzoi kërkesën e paditësve për pagesën e secilit veç e veç në shumë prej 142.00 €, kjo për shkak se të njëjtët nuk kanë arritur vitin jubilar punës, gjatë vlefshmërisë së UA nr.02/2018 sipas nenit 29 paragrafi 5 të këtij udhëzimi dhe nenit 30 par. 5 të UA nr. 02/2018.

Përpos kësaj gjykata e refuzoi si të pabazuar edhe kërkesën e paditësve për kompensimin e shujtave ditore, dhe atë për secilin veç e veç në shumë prej 2,220.00 €, për arsye se me paragrafin 1 të nenit 29 të UA nr.02/2018 si dhe të nenit 30 paragrafi 1 të UA nr.01 /2021, përcaktohet se: *“Paga bazë, shtesat për rrezikshmërinë në punë, puna jashtë orarit, gjatë festave, shujtë ditore, veshmbathje (për zyrtarët policorë) dhe sigurim shëndetësor për personelin e Policisë duhet të jetë në përputhje me vendin e punës, gradën, kualifikimin dhe përvojën e punës, duke u mbështetur në Ligjin për Policinë, sistemin e pagave dhe shtesave në Polici”.* Për arsye se dispozita ligjore e lart cituar nuk e detyron shprehimisht të paditurën për kompensimin e shujtave ditore ashtu siç kanë kërkuar paditësit, andaj vendosi si në dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Objekt i shqyrtimit dhe vlerësimit të gjykatës ishin edhe pretendimet e të paditurës të paraqitura me përgjigje në padi, por gjeti se të njëjtat janë të pabazuara. Kjo për arsye se e paditura nuk mund ta mënjanojë detyrimin, me pretendim se detyrimet financiare nga Udhëzimi Administrativ nuk prodhojnë efekt për shkak se nuk janë në harmoni me Ligjin mbi Ndarjet Buxhetore, gjykata vlerëson se këto akte, në këtë rast Udhëzimet Administrative të lartcekura, janë aprovuar nga struktura të larta të paditurës, e të cilët e kanë pasur për qëllim edhe motivimin e punonjësve për punë kur edhe kanë përcaktuar shpërblime për të njëjtët. Për më tepër derisa ato janë qartë të specifikuar, nuk mund të interpretohen në dëm të tani paditësve duke u thirrur në ekzistimin e mundësive financiare, e as nuk mund të mbetet në diskrecionin e të paditurës se a mundet apo jo për t’i përmbushur detyrimet që rezultojnë nga dispozitat e lartcekura për derisa e paditura me asnjë provë shkresore-analizë buxhetore, nuk e argumenton faktin se ka mungesë të mjeteve buxhetore për përmbushjen e detyrimeve siç kanë kërkuar paditësit.

Lartësia e kamatës së përcaktuar prej 8%, i referohet nenit 382 të LMD-së, e cila do të llogaritet nga marrja e këtij aktgjykimi deri në pagesën definitive.

Sa i përket shpenzimeve të procedurës, gjykata duke u bazuar në nenin 452 par. 1 të LPK-së, ka obliguar të paditurën që paditësit t’i paguaj shpenzimet e procedurës në shumë prej 724.00 € (në emër të përpilimit të padisë shumë prej 624.00 € dhe në emër të taksës për padi shumë prej 100.00 €). Kurse pjesën tjetër të kërkesës për kompensimin e shpenzimeve, gjykata i ka refuzuar në kuptim të nenit 453 të LPK-së.

Për këto shkaqe dhe arsye, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
C.nr.2226/21 datë 20.02.2025

Gjyqtarja
Shpresa Veselaj

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 7 ditësh, nga dita e pranimi, për Gjykatën e Apelit të Kosovës, përmes kësaj Gjykate.